

Prof. Dr. Sulltane KOJQINI-UKAJ

DHUNA E PUSHTETIT JUGOSLLAVË NDAJ SHQIPTARËVE NË RRETHINËN E PEJËS NË VITET E PARA PAS LDB-E

Ishin të shumta format diskriminuese e gjenocidale që qarqet serbe zbatuan ndaj shqiptarëve gjatë dhe pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Gjatë okupimit fashist 1941-1944, qarqet serbe përpiluan programe shfarosëse për shqiptarët. Një i tillë u përpilua më 1941 nga politikani i Lëvizjes çetnike Stevan Moleviq me titull "Serbia homogjene". Moloviq, një Serbi homogjene e parashikonte me masakrimin e shqiptarëve dhe të myslimanëve. Ky program edhe u zbatua në Bihor kur qarqet çetnike serbe bënë ployë të paparë mbi popullsinë boshnjake dhe shqiptare duke masakruar gra, pleq e fëmijë¹. Vetëm në Pejë e Bjellopojë gjetën strehim 6-7 mijë veta. Në mesin e tyre kishte shumë të plagosur gra e fëmijë.² Rrethanat pas kapitullimit të Italisë (shtator 1943) ndryshuan. Më 21 nëntor 1944 Kryesia e AVNOJ-it (KAÇKJ-së) do t'i rehabilitoj çetnikët duke iu lënë duart e lira që të masakronin shqiptarët. Kjo politikë serbe vazhdoi edhe pas LDB-e. Më 5 janar 1945 Vasa Çubrilloviqi me projektin e ri "Pakicat në Jugosllavi" përpiloi Programin për likuidimin e shqiptarëve.³ Në këtë frymë më 23 janar të vitit 1945 nga zyra e OZN-së për Kosovë ishte lëshuar urdhri për ndjekjen masive të shqiptarëve të cilët kishin ndikim në popull. Kjo urdhëresë u zbatua edhe në Pejë. Forcat partizane sapo hynë në Pejë fil-

1 Prof. Dr. Sulltane Kojqini –Ukaj, *Plani i çetnikëve për spastrimin etnik të trojeve shqiptare*, në: Kosova, Prishtinë 2006/ 28, f.294.

2 *AQSH*, Fondi-556, viti 1942-1944, f. 71.

3 Dr. Hakif Bajrami, *Politika pansllaviste serbe në luftë për shfarosjen e shqiptarëve 1836-1999*, në: Vjetar i Arkivit të Kosoves, Prishtinë 2004/ XXXI-XXXII, f.134.

luan zbatimin e kësaj urdhërese. Repartet e OZNA-së në bazë të listave të përpiluara qysh më parë të përcjellura edhe nga repartet ushtarake, arrestonin shqiptar të pafajshëm dhe ekzekutonin pa gjyq. Nga nëntori i vitit 1944-dhjetor 1945 u pushkatuan pa gjyq 3600 burra vetëm në qytetin Pejës.⁴

Formë tjetër e dhunës ishte konfiskimi i pasurisë të gjithë atyre që konsideroheshin kundërshtar të pushtetit.

Komisioni Shtetëror për zbulimin e krimeve të luftës i Jugosllavisë më 9.XII. 1944 njofton Këshillin Popullor të Kosovës për vendimet e AVNOJ-t që pasuria e okupatorit dhe ndihmësve të tij kalon në pronësi të shtetit në bazë nenit 4, alineja 2 të Rregullorës së Komisionit Shtetëror për krime të luftës. Nga kjo urdhëresë përjashtohen ato vepra që janë përfshi me amnestin e Këshillit të Çlirimit Kombëtar të Jugosllavisë Nr. 69 dt, 21 nëntor 1944, që do të thotë çetnikët e amnistuar.⁵ Këto konfiskime do të plotësojnë arkën e shtetit jugosllavë si që thuhej “do të mundësojnë rindërtimin e vendit”.⁶

Në Urdhëresë veç tjerash thuhej se: “Komisionet janë të obligueshme që menjëherë të bëjnë propozimin e përkohshëm të kalimit të pronës së “kriminelëve të luftës” dhe mbështetësve të tij në mbikëqyrjen e shtetit dhe atë në këto raste: Kur ndaj kriminelit të luftës dhe mbështetësit të tij ende nuk është marrë një vendim i prerë gjyqësor si dhe nëse, ende nuk është ngrit padi në gjyq.”⁷

Kryesia e Këshillit Popullor të Kosovës në bazë të nenit 9 të Rregullorës mbi veprimtarinë e komisionit shtetëror për zbulimin e krimeve të okupatorit dhe ndihmësve të tij vendosi që në komision të emërohen: Zekeria Rexha –kryetar, Vladislav Popoviq –sekretar, dhe anëtar Elhami Nimani, Hasan Kryeziu, Bogdan Popoviqi, Ismail Gjinali, Vojin Stankoviq, Xhevdet Pallaska, Sheh Danjollli, Zagorka An-

4 Tahir Zajmi, *Lidhja e Dytë Shqiptare e Prizrenit 1943-1944*, Bruksel, 1965, f. 92.

5 AK, *Fond, Krimet nga Lufta e Dytë Botërore, 1941-1944*, Dok, Urdhëres nr.4 e Komisionit Shtetëror për Verifikimin e krimeve të okupatorit dhe ndihmësve të tyre , dërguar më 9.XII. 1944 KP të Kosovës (komisionit për verifikimin e krimeve të lutës). (Pushteti i vlerësohte kriminel lufte ata që angazhoheshin për kauzën kombëtare).

6 Po aty.

7 Po aty; Upustvo, nr.4 e Komisionit për krime lufte të Jugosllavis Federative Demokratike. Beograd, 9.XII.1944.

drijeviq, Ekrem Hado.⁸

Komisioni për krime të luftës, kishte për detyrë të kërkonte nga gjyqet ushtarake dhe ato civile, raporte për gjykimin e “kriminelëve të luftës dhe armiqve të popullit” si dhe të dhënat për konfiskimin e pasurisë së tundshme e të patundshme.⁹ Për këtë, pranë çdo komisioni për krime lufte, u formua edhe një sektor për verifikimin e “pasurisë së armikut” që do të thotë të gjithë atyre që pushteti i kishte vu në shënjestër. Në bazë të kësaj Rregulloreje komisioni për zbulimin e krimeve të okupatorit dhe ndihmësve të tij për Kosovë vendos që referent i Komisioni të emrohet Svetozar Nediç, avokat nga Rashka, nëpunëse Gonxhe Kolveshi nga Prizreni dhe Vera S. Nediç, maturanthe nga Peja, ndërsa personel teknik Fuad Kadriu, gurbetçar nga Gostivari.¹⁰

Këtyre vendimeve i parapriu edhe letra e Milladin Popoviqit dërguar Komesarëve politik ku urdhërohet që: ” të gjitha bandat kriminale (shqiptarët që nuk pajtoheshin me regjimin komunist S.U.) duhet të luftohen energjikisht dhe pa mëshirë, të çarmatosen fshatrat, ndërsa pasurinë e tyre duhet proklamuar pasuri shtetërore.”¹¹

Në të shumësën e rasteve listat përpiloheshin nga denoncues serb që jo rrallë për hakmarrje ndaj shqiptarëve denonconin persona të pafajshëm që fare nuk kishin të bënin me veprimtari armiqësore.

Burgosjet masive, mobilizimi me dhunë i shqiptarëve në ushtrinë jugosllave, plaçkitjet si dhe marrja e “tepricës” nga populli më i varfër në trevat jugosllave ishin ndër format e dhunës që zbatoheshin ndaj shqiptarëve në vitet e para të pasluftës. Sekuestrimi i pasurisë, e sidomos drithit dhe mishit, dy artikuj kryesorë të jetesës, bëhej me motivacion se ushtria jugosllave kishte nevojë për ta. Ky aksion në Kosovë u zbatua në forma të vrazhda, duke i dënua rëndë të gjithë ata që nuk i përgjigjeshin këtij vendimi. Konfiskimi i pasurisë deri të pragu i derës në kohën kur populli ishte tejet i rraskapitur nga lufta , zbatoheshin veçmas

8 *AK.Fondi. Komisioni për krimet e Luftës së Dytë Botërore, 1941-1944.* Dt.11. II.1945. (Zekiria Rexha ishte figurë me ndikim në popull dhe për ta dobësuar këtë em[rohet në krye të këtij komisioni S.U.).

9 Po aty.

10 *AK.Fondi.Krimet e LDB-e, Dok. Komisioni për konstatimin e krimeve te okupatorit dhe ndihmësve tee tij për Kosovë e Metohi,* nr. 44 dt.11.07. 1945, Prizren.

11 *AK.Fondi KK-K10, viti 1944.* Doku.mban datën 30.XI. 1944 dhe është i nënshruar nga Milladin Popoviqi sekretar i KK.

ndaj atyre që kishin luftuar komunizmin dhe pushtetin e ri, e që në masë të madhe ishin burgosur, pushkatuar e internuar. Kështu u veprua me shumë familje pejane.

Viktimë e kësaj dhune ishin shumë patriotë e intelektual të Pejës. Në pozitë shumë të vështirë u vunë elementet më demokratik e më atdhetarë e veçmas familjet e veprimtarëve të NDSH-së. Këto familje së pari duhej izoluar kurse hap tjetër ishte grabitja e pronës, përmes detyrimit që të largohen nga Kosova. Pronat e grabitura iu ndaheshin kolonistëve serbë e malazez. Familje të tilla në Pejë ishin familja e Bedri Pejani, Emrush Myftarit, Zhukë Haxhisë, Rexhep Brojës, Vehbi Tarakut e begollajve të Pejës e shumë të tjera.¹² Vrasjet në emër të luftës kundër forcave kundërrevolucionare, burgosjet dhe dënimet në emër të “popullit” ndaj këtyre veprimtarëve të kauzës kombëtare, konfiskimi i pronës dhe pasurisë, pasqyronin këtë periudhë të vështirë kohore për popullin shqiptar në Jugosllavinë komuniste. Si pasojë e padrejtësive që bëheshin mbi shqiptarët deri në vitin 1950, nëpër vite do të likfidohen 49.000 shqiptar, ndërsa prej trojeve të veta, si pasojë e Marrëveshjes Xhentlemen 1953 në mes të Jugosllavisë dhe Turqisë deri në vitin 1967 do të shpërngulen në Turqi 415.000 shqiptarë, turq dhe musliman.¹³

Të gjitha këto masa dhune mbështetshin në realizimin në praktikë të elaborateve të Vasa Qubrilloviqit, Vlladan Gjorgjeviqit, Svetozar Miletiqit, Ivo Andriqit dhe ideologëve të tjerë të nacional-shovinizmit serb.

Në gjyqet ushtarake e civile u burgosën dhe u pushkatuan shumë atdhetar që aspironin bashkimin kombëtar në një shtet demokratik properëndimor. Gjykatat e rrethit dhe ato të qarkut gjatë periudhës 1945-1948, kishin shqiptuar dënime të rënda ndaj udhëheqësve dhe veprimtarëve të Rezistencës kombëtare përfshirë edhe dënime me vdekje si: Emrush Myftari, Bedri Pejani, dy figura pejane me peshë të madhe kombëtare. Sipas të dhënave arkivore në Gjyqin e Qarkut në Pejë të datës 30 maj 1946 kishte 144 të burgosur. Sipas këtij dokumenti për 51 veta ishte ngrit aktakuza, të dënuar ishin 17, të dënuar pa vendim gjyqë-

12 Po aty, f.183.

13 Hakif Bajrami, *Politika pansllaviste...*

sor 47, dhe ndër hetime 29.¹⁴

Ishin të shumtë ata që u dënuan pa gjyqe duke i marrë nga shtëpitë e tyre apo në rrugë për t'i pushkatuar në Tabjet e Pejës. Në mesim e tyre ishte edhe i riu Xhemajl Kojqini i cili u muar në rrugë dhe u pushkatua më 17 nëntor ditën kur partizanët hynë në Pejë.¹⁵

Shumica e atdhetarëve dhe veprimtarëve pejan ishin në burgjet tjera të Kosovës. Në Gjykatën e Prizrenit me grupin e atdhetarëve shkodran At Bernard Llupi, Marie Shllaku, Kolë Parubi e mesuesi Gjergj Martin ishin edhe shumë pejan emrat e të cilëve lanë gjurmë në historinë tonë kombëtare. Këta i takonin Komitetit të Rinisë Nacional Demokratike në Pejë të organizuar nga Marsel Vuçaj. Në këtë grup ishin të përvëshirë Isa Çavolli, Masar Begolli, Hamëz Begolli, Skendr Riza, Osman Basha, Kamber Pajazit, Jak Krasniqi, Viktor Gashi, Shefqet Kelmendi, Miftar Bala, Mehmet Vokshi, Binak Dema dhe Gjergj Deda.¹⁶

Pushteti kishte parapa edhe një masë tjetër. Të pushkatuarve dhe të dënuarëve t'u konfiskohej pasuria dhe familjet të internoheshin në vende të ndryshme të Jugosllavisë.¹⁷

Krahas saj Prokuroria Publike dënonte me shuma drastike sh-tresën e zejtarëve, tregtarëve, bujqve e të tjerëve duke i renditur në listat e gjata të "përfituesve të luftës".

Këto masa në Pejë dhe rrethinë zbatoheshin më egërsisht se kudo tjetër për shkak të elementit kolonist serbo-malazez që ishte më i përqendruar në këtë rajon.

Ne kësaj here do të përqendrohemi më tepër në zbatimin i rekuizimit në Pejë dhe rrethinë si masë efikase për shpronësimin dhe varfërimin e shqiptarëve.

Pas përfundimit të LDB-e një nga çështjet më të rëndësishme politike dhe ekonomike në Kosovë përbënte rregullimi i marrëdhënieve agrare dhe zgjidhja përfundimtare e problemit të pronësisë mbi tokën. Zbatimi i saj para së gjithash kishte për qëllim që përmes të ashtuquaj-

14 *Prokuroria Publike e KAKMK 1945/46*, kutia 5, Peja Dok Tabelarni pregled stanja okružnog zatvora u Peći dt,30 maj 1946.

15 Deklarat e Jashar Kojqinit dhën me 2.gusht.1965 në Pejë,(vëlla i Xhemajl Kojqinit).

16 *AK. Fondi.Gjyqi I Qarkut Prizren*, LP.21/46.

17 *AK.Dok. 77/54*, Aktvendim për konfiskimin e pasurisë.

turës Revizioni i reformës Agrare të kryhen padrejtësi ndaj shqiptarëve edhe ashtu të varfër e të shkatruar nga lufta.¹⁸

Qëllimi parësor i kësaj reforme ishte varfërimi i shqiptarëve në atë shkallë sa t'i detyronte të thyheshin e më vonë edhe të shpërnguleshin.¹⁹

Pas LDB-e procesi i rishikimit të Reformës Agrare iu ngarkua Ministrisë së Kolonizimit dhe Ministrisë së Bujqësisë e cila u udhëhoq nga Vasa Çubrilloviqi i cili pak kohë para se të merrte këtë detyrë, më 1944, kishte përgatitur referatin e ri për shpërnguljen e shqiptarëve nga Jugosllavia. E gjithë kjo lidhej ngushtë me rikonizimin me popullsi sllave të këtyre rajoneve. Të kujtojmë shprehjen e Çubrilloviqit "...në Kosovë duhet kolonizuar elementin sllav të sigurt". Këtë politikë e shprehu edhe ligji për rishikimin e reformës agrare i cili u aprovua nga organet qendrore të Federatës Jugosllave me 3 gusht të vitit 1945.²⁰

Duhet theksuar se në Kosovë rikonizimi nuk mund të zbatohet siç arsyetohej nën pretekstin e "tokës së tepërt" sepse në Kosovë tokë të tillë nuk kishte. Këtë e argumenton edhe delegacioni shqiptar që vizitoi Titon me 6 prill të vitit 1945. Në këtë delegacion merrin pjesë: Mehmet Hoxha, Halim Spahija, Vesel Rexhepi...etj. Në bisedë me Titon shprehën brengosjen e tyre për dhunën që OZN-a dhe UDB-a zbatonin ndaj shqiptarëve në Kosovë. Veç saj ata theksuan se "është e drejtë që në radhë të pare të marrim tokë ne, qe jemi aty, e që kemi trashëguar prej gjyshërve e stërgjyshe"²¹ Këto shqetësime të delegacionit shqiptar nuk mbeten pa u ndëshkuar nga organet e pushtetit të kohës. Një numër i konsiderueshëm i këtij delegacionit u burgosën, u dënuan me shumë vite burgim e u pushkatuan. Në mesin e të pushkatuarëve ishte edhe Halim Spahija.

Gjendja ekonomike e shqiptarëve u keqësua edhe më tepër, pasi në kurriz të saj rënduan detyrimet e shumta për t'i mbajtur forcat e mëdha ushtarake që operonin në këto vise e që vritnin shqiptar të pafajshëm. Repartet ushtarake jugosllave përdorën për furnizim metodën

18 Lefter Nasi, *Ripushtimi i Kosovës –Shtator 1944- Korrik 1945*, Tiranë, 1994, f.190-191.

19 Po aty, f.193.

20 Po aty .

21 *Delegacioni i shqiptarëve te Kosovës viziton Marshallin Tito*, në: Rilindja, 15 prill 1945, f.1.

e rekuizimit, grumbullimin e detyruar të prodhimeve bujqësore e blegtorale. Rekuizimet u shndëruan në grabitje të hapura të popullsisë shqiptare. Këto akte u hetuan në përfundim të LDB-e. Në raportin e UNÇ të Shqipërisë thuhet se populli në rajonin e Pejës ishte i pakënaqur dhe i revoltuar edhe për “shkak të refuzimeve të shumta dhe me detyrime”.²² Kjo shkaktoi një pakënaqësi të përgjithshme sidomos të fshatarësia që ishte e lidhur me tokën dhe pronën e tij. Raporte të shumta njoftojnë se në Pejë, në qershor të vitit 1945, gjendja ekonomike ishte shumë e vështirë. Sasi të mëdha drithi transportoheshin në Mal të Zi dhe në Sanxhak, e në anën tjetër duhej siguruar ushqim për kolonistët e ardhur nga Serbia e Mali i Zi, si dhe për qindra familje të ardhur nga Sanxhaku pas masakrës së Bihorit.²³(3.1.1943). Këto familje kryesisht u vendosën në Pejë e rrethinë. Në fillim ato u sistemuan në shumë familje shqiptare që patën vullnet të mirë t’i strehonin këta nevojtarë të ikur nga masakrat çetnike në rajonin e Sanxhakut.

Gjendjen e vështirësoi edhe më tepër vendimi i marrë për kthimin e kolonistëve serbë e malazez në Kosovë.

Masë tjetër ishte grabitja e pasurisë të gjithë atyre që cilësoheshin si “*përfituesve të luftës*”. Masat që u përdorën për grabitjen e pasurisë së tundshme e të patundshme ishin të pajustificueshme. Kjo masë në Pejë u zbatua në shumë familje që kishin krijuar një lloj pasurie gjatë LDB-e por edhe që e kishin trashëguar më herët. Në listën e gjatë që komisioni përkatës i caktuar nga strukturat e shtetit jugosllav e kishte hartuar për konfiskimin e pasurisë ishin edhe shumë familje nga Peja, Istogu e Gjakova. Sipas kësaj liste komisioni në fjalë kishte shqyrtuar mundësitë që disave prej tyre t’iu zvoglohet dënimi me gjobë, siç thuhet “nuk kanë mundës t’a paguanin”. Kjo zbritje e gjobës u bë pas shumë ankesave që pejanet bënë në Prokurorin Publike në Prizren²⁴. Kjo bëri që pas verifikimit të pasurisë nga komisioni përkatës dënimet të zbritën. Në mesin e atyre që bënë ankesë pranë Prokurorisë Publike në Prizren për gjobat e larta e të kundërligjshme dhe të pajustificueshme ishin: Ahmet Meraku, Ymer Muhaxheri, Shaban Sadiku, Nazmi Belegu. Të gjitha ankesat mbajnë datën 18.7.1946. Ankesa të tilla ishin

22 Lefter Nasi, *Ripushtimi i Kosovës...*, f.194.

23 Ali Hadri, *Këshillat NÇ ne Kosovë*, Prishtinë, 1974, f. 174.

24 *AK.Fondi Prokuroria Publike-Prizren*, Dok. Izveshtaj po molbi ratnog dobitnika iz Peći, 4 tetor 1946.

përsëritë disa herë në Prokurorin Publike të Prizrenit e të Prishtinës.²⁵ Sipas një raporti të Drejtoratit për Furnizim Shtetëror MPP-Prishtinë në vitin 1950 në Kosovë kishte 8620 ankesa kundër padrejtësive që bëheshin në dëm të familjeve shqiptare duke iu konfiskuar pasurin dhe vetëm në Pejë ishin 89, në Gjakovë 332 , ndërsa në Gurakoc 250. Po sipas këtij raporti ishin refuzuar për shqyrtim 2695 ankesa.²⁶

Komisioni për caktimin e përfituesve të luftës kishte rradhitur në grupin e parë: Joniz Kapuçin, Hivzi Ibishagën, Hivzi Kelmendin, Nazmi Belegun, Ahmet Merakun, Ymer Muhagjerin. Këta cilësoheshin si përfituesit më të mëdhenjë gjatë luftimeve.

Janë të shumët të cilësuarit si "përfitues luftime" e që dosjet e tyre gjenden në Arkivin e Kosovës në Fondin Krimet e Luftës së Dytë Botërore 1941-1944. Në Pejë si të tillë ishin cilësuar:

1.EMIN TIGANI, industrialist, nga Peja. I dënuar të paguaj 902.000 dinarë në emër të vlerësimit ad'hok si përfitues luftime. Komisioni kishte vlerësuar se duhet të mbetet në të njëjtën shumë.

2.MUSTAFË MULLIQI nga Peja. Në emër të pasurisë së tepërt, të fituar gjatë luftës, dënohej të paguaj shtetit të njëjtën shumë si pasardhësi i tij. Komisioni vlerësues shprehej së këta të dy kanë mundësi të përmbushin obligimin ndaj shtetit. Këtë vendim komisioni verifikues e kishte vendos më 20 dhjetor të vitit 1945 me sugjerim që nuk mund të ndryshohej.

3.HIVZI dhe vëllezërit tjerë Ibishaga , tregtarë, nga Peja. Ishin të ndëshkuar më herët me shumën prej 300.000. Pas shqyrtimit të komisionit ishte vlerësuar se ka mundësi të paguajnë 200.000 dinarë. Komisioni vlerëson se kjo shumë të hollash është reale sepse vëllezërit Ibishaga nga viti 1941 deri në vitin 1944, në Tiranë, kishin një pasuri të ndjeshme. Në Pejë kanë vetëm pasurinë e patundshme, një pjesë të vogël të tokës, disa shtëpi dhe një dyqan të vogël.

4.NIMON BOKLETA, tregtar, nga Peja. Fillimisht ishte dënuar t'i paguaj 350.000 dinarë. Komisioni vlerësues shumë e caktuar e kishte zbritur në 60.000 dinarë me arsyetimin se "ai duhet të punoi edhe më tej në ngritjen e ekonomisë dhe të tregtisë".

25 Po aty, ankesat janë bërë nga Ahmet Meraku, Nazmi Belegu, Ymer Muhaxheri, Shaban Sadiku, më 12.07.1946.në Prokurorin Publike në Prizren.

26 A.K. *Fondi Prok, Publike Prishtinë* , Shumë sekret viti 1950/51, K-9.

5.MYRTEZA GASHI, tregtar, nga Peja. I vlerësuar nga komisioni ti paguaj shtetit 400.000 dinarë. Pas shqyrtimit të gjendjes kjo shumë ishte zbritur në 70.000 dinarë për faktin se vetëm aq kishte mundësi të paguante.

6.SHABAN SAKA, tregtar, nga Peja. I dënuar si “përfitues luftime” me shumë prej 110.000 din., por më vonë komisioni kishte vlerësuar së nuk kishte mundësi ta paguaj gjithë këtë shumë dhe e kishte liruar krejtësisht duke e vlerësuar si njeri të ndershëm.

7.JONUZ KAPUQI - liferant²⁷. Fillimisht i dënuar me shumë prej 1.000.000 dinarë. Pas shumë konsultimeve komisioni e kishte zbritur në 400.000 dinarë që konsiderohej shumë reale e cila mund të paguhej.

8.RAMIZ SHABANI - kafexhi. I dënuar me 105.000 dinarë, dhe më pas komisioni kishte vlerësuar që të lirohet nga detyrimi i pagesë për faktin se ishte një kafexhi i vogël dhe psikikisht i thyer dhe se tani djali i tij ishte i mobilizuar në Ushtrinë Jugosllave(mobilizimi bëhej me dhunë S.U.).

9.ALUSH ZEKA - pemëshitës. Ishte dënuar me shumë prej 105.000 dinarë dhe pas shqyrtimit të gjendjes, komisioni vlerësues propozon që të lirohet krejtësisht, për faktin se nuk kishte kurrfarë pasurie të tundshme dhe të patundshme.

10.SELIM BEKQELI - kafexhi. I dënuar me shumë prej 200.000 din. Komisioni vlerësues kishte propozuar që të lirohet për faktin se ka qenë vetëm kafexhi dhe nuk ka pas mundësi të krijojë ndonjë kapital.

11.SHYQRI BELEGU - liferant. I dënuar me pagën prej 757.000 din. Pas shqyrtimit të gjendjes ishte vlerësuar që shuma të zbritet në 120.000 din., me arsyetim se gjatë luftime dhe menjëherë pas saj një pjesë të madhe të pasurisë ua kishte shpërndar të varfërve. Po ashtu kishte ndihmuar edhe ushtrinë jugosllave.

12.HIVZI KELMENDI, tregtar, nga Peja. Si përfitues i luftës ishte dënuar me shumë prej 200.000 din. Komisioni kishte dhënë propozim që të zbritet në 150.000 din., me arsyetim se këtë shumë mund ta paguaj duke u arsyetuar se gjatë LDB –e kishte qenë tregtar i madh.

27 Liferant –furnizues.

13.HIVZI JENINA - tregtar. I dënuar me shumën prej 500.000 din. Komisioni kishte sugjerua që t'i zbritet në 100.000 dinarë edhe pse sipas tyre “ gjatë lufte kishte qenë njëri prej spekulantëve të dalluar”.

14.ALEKSA POPADIQ - tregtar. Si përfitues lufte ishte dënuar me shumën prej 1.600.000 din. Komisioni vlerësues kishte sugjeruar që shuma të zbritet në 500.000 din., me arsyetim se ka blerë shtëpi në Beograd e cila vlerësohet të këtë kushtuar afro 300.000 din.

15.JAKUP RUGOVA, tregtar, nga Peja , ishte dënuar me shumën prej 500.000 din. Pas vlerësimit të komisionit shuma ishte zbritur në 100.000 din.

16.JAKUP H.JAKUPI, tregtar, nga Peja. Fillimisht i dënuar me shumën prej 500.000 din. Mirëpo, pas verifikimit të gjendjes, komisioni vlerësues e kishte zbritur në 100.000 din., me arsyetim se këtë shumë Jakupi ka mundësi ta paguaj. Jakupi gjatë LDB-e kishte qenë aksionar në shoqërinë tregtare të Pejës.

17.AHMET MERAKU - tregtar. I obliguar nga shteti jugosllav që si përfitues lufte të paguaj shumën prej 700.000 din. Komisioni verifikues sygjeron që ti zbritet në 150.000 din., me arsyetim se kjo është shumë reale që Ahmeti mund ta paguaj. Edhe ky sipas dokumentit që posedojmë ka qenë tregtar i dalluar në Pejë.

18.ADEM DUSHI. Gjatë LDB-e, kishte punuar tregtar në Pejë. Pas lufte ishte obliguar që t'i paguaj shtetit shumën marramendëse prej 16.435.721 din. Komisioni vlerësues jep mendimin se kjo shumë nuk duhet zbritur, siç thuhet në vlerësim, me arsyetim se “ gjatë lufte ka qenë ndër faktorët kryesor në ekonominë e Kosovës dhe se ka pasur kapital të konsiderueshëm edhe në Tiranë.

19.KOLË NDUELLESHI - tregtar. I vlerësuar si përfitues luftes ishte dënuar të paguaj shumën prej 100.000 din. Komisioni kishte sygjeruar se duhet liruar krejtësisht nga ky obligim me arsyetimin se ka pas një tregti të vogël dhe nuk është në gjendje ta paguaj shumën e caktuar.

20.SHABAN MURATI - kafexhi. I dënuar me shumën prej 45.000 din. Pas verifikimit të pasurisë komisioni kishte sugjeruar të lirohet nga pagesa, me arsyetim se gjendja materiale e tij nuk është e mirë dhe nuk ka mundësi të paguaj shumën në fjalë.

21.YMER MUHAGJERI, tregtar, nga Peja. Ishte vlerësuar, nga strukturat përkatëse të shtetit jugosllavë, që si përfitues lufte të paguaj

shumën 1.260.000 din. Pas verifikimit që kishte bërë komisioni dhe pas ankesës që ai kishte bërë në Prokurorin Publike në Prizren ishte konstatuar se gjatë lufte okupatori e kishte djegur dhe plaçkitur pasurinë e tij. Bazuar në këto fakte komisioni vlerësues kishte sugjeruar të zbritet shumA në 100.000 din., me konstatim që mund ta paguaj.(Në vitin 1956 në valën e shpërnguljeve për Turqi së bashku me familje vendoset në Izmir).

22.HIVZI MULLA - kafexhi. Pas lufte cilësuar si përfitues lufte ishte obliguar që të paguaj shtetit shumën prej 120.000 din. Pas verifikimit të gjendjes materiale të tij ishte konstatuar se këtë shumë nuk ka mundësi ta paguaj. Komision kishte dhënë mendimin që të lirohej nga pagesa.

23.VEHBI MALA -mbathtar. I dënuar me pagën prej 150.000 din. Komisioni verifikues kishte sugjeruar që kjo shumë të zbritet në 50.000 din., me konstatimin se vetëm këtë shumë ka mundësi reale të paguaj. Gjatë lufte përveç profesionit të mbathtarit ka punuar edhe gjësende tjera për okupatorin thuhet në konstatimin e komisionit verifikues .

24.MINIR KYQUKALIU –rentier. Si përfitues lufte ishte dënuar me shumën prej 78.000 din. Pas verifikimit të gjendjes komisioni kishte propozuar që shuma ti zbritet në 50.000 din. Komisioni kishte vlerësuar se gjatë lufte ka pas përfitime pa u aktivizuar vet në punë.

25.NAIL KADIJA - tregtar. I dënuar me pagën prej 500.000 din. Edhe pse ka qenë tregtar i njohur sipas komisionit vlerësues ka mundësi të paguaj vetëm 75.000 din.

26.REXHEP MULLA TRAKANIQI - tregtar. Fillimisht ishte dënuar si përfitues lufte me shumën prej 150.000 din. Mirëpo komisioni për vlerësimin e pasurisë kishte dhënë mendimin që kjo shumë të zbritet në 80.000 din. Ky komision bënë të ditur se gjatë LDB-e Rexhepi kishte qenë tregtar në zë dhe kishte fituar mjaftë .

27.SHYQYRI DEVOLLI, tregtar, nga Peja. Pas LDB-e ishte obliguar që si përfitues lufte shtetit t'i paguaj shumën prej 70.000 din. Pas verifikimit të pasurisë komisioni përkatës kishte dhënë mendimi që të lirohet krejtësisht nga pagesa me arsyetim se kishte qenë tregtar i vogël.

28.HAJRULLAH MALA – tishler. Ishte dënuar si përfitues lufte me shumën prej 80.000 din. Komisioni vlerësues kishte propozuar të

lirohet nga shuma e caktuar duke e vlerësua si njeri të ndershëm që nuk ka mundësi ta paguaj shumën e caktuar.

29. IBRAHIM BAKRAÇI – tregtar. I dënuar si përfitues lufte të paguaj shumën prej 70.000 din. Komisioni vlerësues sugjeron të lirohet krejtësisht nga pagesa me arsyetimin se ka qenë tregtar i vogël.

30. FETË GACAFERI – tregtar. I dënuar me shumën prej 80.000 din. Komisioni vlerësues jep mendimin se duhet liruar nga pagesa.

31. MULA REXHEP XHELADINI, tregtar, nga Peja. I dënuar si përfitues lufte me shumën 250.000 din. Pas vlerësimit të pasurisë nga ana e komisioni shuma e caktuar zbritet në 60.000 din. Komisioni vlerëson se nuk ka mundësi të paguaj shumën në fjalë. Gjatë LDB-e ishte tregtar i vogël edhe pse ka pas fitime të konsiderueshme konstaton komisioni.

32. KURTESH FETA - tregtar. Dënohet si përfitues lufte me shumën prej 90.000 din. Komisioni verifikues jep mendimin që të lirohet me arsyetim se nuk ka mundësi reale të paguaj shumën në fjalë,

33. SHYQRI BAKRAQI, tregtar, nga Peja. I dënuar, që si përfitues lufte, me shumën prej 120.000 din. Komisioni vlerësues kishte propozuar ta zbres në 60.000 din., edhe pse sipas komisionit në fjalë, gjatë lufte ka pas përfitime por sot nuk është në gjendje të paguaj më shumë se 60.000 din. Mirëpo, veç kësaj Gjykata e Qarkut e kishte dënuar edhe me shumën prej 35.000 din., që sipas gjykatës kishte qenë njeri spekulant.

34. ESHREF ABDURAHMONI - tregtar. I dënuar si përfitues lufte me shumën prej 500.000 din. Komisioni vlerësues kishte konstatuar shumë të lartë për mundësit e tij duke e zbritur atë në 100.000 din. I njëjti, sipas komisionit, ka përfituar nga gjermanët duke shkëmbyer mallra në relacionin Pejë- Mitrovicë.

35. MILE MIHAJLLOVIQ, zejtar, nga Peja. I dënuar me shumën 40.000 din. Komisioni sugjeron që si zejtar nuk është në gjendje ta paguaj shumën e paraparë.

36. DANICA POÇUÇ - rentiere. E dënuar me shumën prej 250.000 din. Komisioni propozon që shuma e caktuar të zbritet në 50.000 din., me arsyetim se nuk ka mundësi reale ta paguaj një shumë aq të madhe, edhe pse sipas tyre, Danica gjatë lufte kishte përfituar duke u mbështetur te okupatori.

37.TATJANA GASHIQ – rentiere. Ishte dënuar të paguaj 1.780.000 din. Komisioni pas vlerësimit të gjendjes së pasurisë së saj kishte konstatuar se duhet zbritur në 200.000 din., me arsyetim se këtë shumë ka mundësi ta paguaj.

38.YMER DEVOLLI - tregtar. Dënuar për pasurim gjatë lufte me shumën prej 100.000 din. Komisioni kishte propozuar që të lirohet nga pagesa me arsyetimin se ishte tregtar i vogël dhe se nuk mund ta mbulonte pagesën në fjalë.

39.DULË EMIN KOÇANI -tregtar. Dënuar me pagën prej 60.000 din . Komisioni pas verifikimit të pasurisë kishte propozuar që të lirohet nga pagesa.

40.ASLLAN GJIKOLLI, tregtar, nga Peja. Dënuar me shumën prej 100.000 din. Pas verifikimit të pasurisë komisioni kishte propozuar që të lirohet nga pagesa sepse gjatë lufte okupatori e kishte plaçkitur dhe djegur.(Italia fashiste në vitin 1943 kishte djegur qarshin në Pejë gjë që kishte shkaktuar dëme të mëdha pronarëve të këtyre dyqaneve S.U).

41.JONUZ PUDAROLLI. Ishte obliguar të paguaj shtetit një shumë prej 180.000 din., dhe pas verifikimit të gjendjes komisioni verifikues kishte propozuar që të zbritet në 80.000 din., sepse vetëm këtë shumë ishte në gjendje ta paguaj.

42.AGUSH MALUSHAGA , tregtar, i dënuar si përfitues lufte me pagën prej 80.000 din, dhe më pas komisioni kishte konstatuar se nuk mund të paguaj më shumë së 40.000 din.

43.OSMAN FEKA, tregtar, nga Peja. Dënuar të paguaj shumën prej në 500.000 din. Sipas komisionit verifikues shuma e caktuar ishte e lartë dhe e pamundshme të paguhet. Komisioni kishte vlerësuar se gjatë lufte është pasuruar duke bashkëpunuar me okupatorin.

44.MUHAREM BURDUNIQI - tregtar. Si përfitues lufte ishte dënuar me shumën prej 1.104.000 din (edhe pse kështu është në dokument kjo shumë marramendëse mund të jetë edhe gabim). Komisioni vlerëson se ka mundësi të paguaj vetëm 300.000 .

45.REMZI KRYEZIU. Fillimisht ishte dënuar si përfitues lufte me shumën prej 807.300 Pas vlerësimit të komisionit shuma zbritet në 160.000 din. Ai gjatë lufte kishte blerë një shtëpi dhe një tjetër e kishte rinovuar, prandaj nuk kishte mundësi të paguaj shumën e caktuar konstaton komisioni vlerësues.

46.MUSA KARPITI - tregtar. Pas lufte ishte vlerësuar si përfitues dhe për këtë ishte dënuar të paguaj shtetit 683.772 din. Mirëpo edhe pse ka qenë tregtar dhish ai nuk është në gjendje të paguaj më shumë se 75.000 din., kishte vlerësuar komisioni verifikues.

47.RAMIZ DUKA - pemë shitës. I vlerësuar si përfitues lufte ishte dënuar me shumën prej 249.700 din. Komisioni verifikues kishte konstatuar se Ramiz Duka kishte qenë tregtar i imët dhe kishte sugjeruar që të lirohet nga pagesa.

48.ABDULLAH BERISHA - hanxhi.I vlerësuar si përfitues lufte nga komisioni për krime të luftës ishte dënuar me pagën prej 230.000 din. Komisioni verifikues propozon të lirohet nga pagesa me arsyetim se mundësit nuk e lejojnë ta mbulojë shumën në fjalë.

49.YMER SHARAPOLLI. Gjatë lufte kishte pasur një bujtinë. Komisioni për krime lufte e kishte renditur në përfitues të luftës duke e dënuar me 230.000 din. Komisioni për verifikimin e pasurisë vlerëson të lirohet nga pagesa me arsyetimin se nuk posedon pasuri.

50.BEÇIR KOLICA - tregtar. I vlerësuar si përfitues lufte ishte dënuar me shumën prej 228.000 din. Edhe pse, sipas komisionit ka përfituar gjatë lufte, sugjerohet të lirohet nga pagesa.

51.ADEM MALA - këpucar. Si përfitues i luftës dënohet me shumën prej 730.000 din. Komisioni vlerësues kishte sugjeruar që shuma në fjalë të zbritet në 100.000 din. Ademi vlerësohet si këpucar i mirë dhe i suksesshëm .

52.JONUZ KËRVESHI - kafexhi. Pas lufte i vlerësuar si përfitues lufte ishte dënuar me shumën prej 4.080.000.din. Komisioni kishte shpreh mendimin se duhet liruar nga pagesa me konstatimin se Jonuzi gjatë lufte kishte bashkëpunuar me Stergjeviqin i cili pas lufte e kishte tërënjek kapitalin e tij dhe Jonuzi kishte mbet pa asgjë.

53.JANIQIJE BOSHKOVIQ - kafexhi. Pas lufte ishte vlerësuar së duhej të paguaj shumën prej 140.000 din. Komisioni kishte vlerësuar që të lirohet nga pagesa me arsyetim se tash nuk punon asgjë.

54.MUHAREM GJIKOLLI – tregtar. Dënuar si përfitues lufte me pagën prej 1.120.000 din. Komisioni verifikues kishte dhënë mendim se Kahremani gjatë lufte ishte plaçkitur nga okupatori, ndërsa pas lufte pasuria i ishte konfiskuar dhe sot nuk ka asgjë. Prandaj nuk mund të paguaj një shumë aq të madhe.

55.SHABAN BERJALOLLI - tregtar. Fillimisht ishte dënuar me shumë prej 75.000 din. Komisioni vlerësues ka konstatuar se është plaçkitur nga okupatori dhe i biri në vitin 1943 ishte vrarë në luftë kundër okupatorit. Sot nuk posedon pasuri. Kjo na shtynë ta lirojmë nga pagesa .

56.SHABAN SADIKU - tregtar. Dënuar me shumë prej 400.000 din. Komisioni pas verifikimit të pasurisë e kishte zbritur atë në 150.000 din. Gjatë lufte kishte përfituar duke u mbështetur të okupatori thuhet në raport të komisionit vlerësues.

57.SYLË SHABANI - tregtar. Pas lufte i dënuar me 549.000 din., ndërsa komisioni verifikues vlerëson se mund t'i paguaj 50.000din.

58.SHEFQET BEGOLLI - rentier. Dënuar si përfitues lufte me shumë prej 247.000 din. Pas verifikimit të pasurisë komisioni sugjeron që t'i zbritet në 100.000 din. Komisioni vlerëson se Shefqeti duke shfrytëzuar pozitën e begut ka marrë të katërtën nga fshatarët dhe në këtë mënyrë është pasuruar.

59.SHERIF BILALLI - pemëshitës. Ishte vlerësuar përfitues lufte dhe dënuar me shumë prej 75.000 din. Komisioni verifikues propozon të lirohet nga paga me arsy etimin se "është i varfër" dhe nuk ka mundësi të paguaj.

60.NIKO IVEZIQ – kafexhi. I vlerësuar si përfitues i luftës, ishte dënuar me shumë prej 330.000 din. Komisioni kishte vlerësuar që kjo shumë të zbritet në 80.000 din. Sipas komisionit vlerësues Niko, gjatë lufte kishte prodhuar një shumë të madhe pijesh alkoolike, yndyrash dhe nga fshatarët e ka mbledhë të dhjetën.

61.KOSTA BERKOVIQ – tregtar. Pas lufte i vlerësuar si përfitues lufte ishte dënuar me shumë 1.000.000 din. Mendimi i komisionit verifikues ishte që shuma e paraparë të zbritet në 100.000 din., që sipas komisionit konsiderohet e arsyeshme.

62.REXHEP BELEGU - bakall. Menjëherë pas lufte ishte dënuar të paguaj shumë prej 200.000 din. Pas verifikimit të pasurisë komisioni shpreh mendimin të lirohet sepse ishte tregtar fare i vogël dhe nuk ishte në gjendje të paguaj shumë e paraparë.

63.SHPEND FERIZI – saraç. I cilësuar si përfitues lufte ishte dënuar me shumë prej 100.000 din. Komisioni verifikues sugjeron që të lirohet me arsyetimin se është një zejtar fare i vogël.

64. BORO JOÇKIQ - tregtar. Pas lufte i dënuar me shumë prej 400.000 din. Vlerësimi i komisionit ishte që të lirohet ngase gjatë lufte nuk ka mundur të pajiset me mallra.

65. NAZMI BELEGU - tregtar. Si përfitues lufte ishte dënuar me shumë prej 1.100.000 din. Pas verifikimit të gjendjes materiale është propozuar që dënimi të zbritet në 150.000 din. Sipas komisionit, gjatë LDB-e kishte dy dyqane dhe fitimi tij ishte i mirë, mirëpo ka pas edhe dëmtime kur okupatori italian e djeg Pejën (1943). Ky është vlerësim i komisionit verifikues.

66. BOGOLUB ZVANJIK - tregtar. Dënuar si përfitues lufte me 364.000 din. Komisioni vlerësues propozohet të lirohet nga paga sepse gjatë lufte nga okupatori ishte dëmtuar.

67. AJDIN SAHITI – bujk. Fillimisht ishte dënuar me pagën prej 100.000 din. Komisioni verifikues shpreh mendimin të lirohet pasi që një pjesë e tokës iu është konfiskuar me parë.

68. SAHID (JASHAR) PEPA - rentier (mbiemri mund të jetë gabim se nuk lexohet mirë). Fillimisht i dënuar me pagën prej 155.000 din. Komisioni verifikues kishte vlerësuar se dënimi në fjalë është i pamundur të paguhet dhe propozon të lirohet me arsyetim se reforma agrare ia ka konfiskuar pjesën më të madhe të tokës në fshat.

Komisioni i autorizuar nga strukturat e shtetit të bëjë vlerësimin e “përfitueseve të luftës” i kishte sistemuar në dy grupe: a. Shkalla e parë, dhe b. Shkalla e dytë. Në shkallën e parë ishin të akuzuar 114 familje. Prej tyre 67 të dënuar, 36 të liruar, ndërsa 11 raste kishin mbetur të pazgjedhura. Të pakënaqur me dënimet e larta ishin të evidentuar 44 raste që kishin bërë ankesë për konfiskim të pajustificueshme të pasurisë. Në shkallën e dytë përfshiheshin vetëm dy familje.

Sipas këtij raporti vlera e përgjithshme e konfiskimit të pasurisë në emër të pasurimit gjatë lufte arrinte vlerën prej 63.277.493 din. Nëse kësaj ia shtojmë edhe Rrethin e Istogut dhe të Gjakovës atëherë vlera e përgjithshme arrin shumë prej 81.878.493 din. Kësaj shume duhet shtuar edhe dënimet që kapin vlerën e përgjithshme prej 2.596.300 din.²⁸

28 AK. Profiterët e Luftës së Dytë Botëror, Pejë, Gjakovë, Istog, Vushtrri, Mitrovicë. Dok. Tabelarin pregled ratnih dobitnika na području Okruga Metohijskog-Pejë.

Sipas këtij raporti tabelor të hartuar më 16.III.1946, konstatojmë edhe strukturën e sociale të profiteve të luftës. Tregtarë numëroreshin 51 veta, industrialist 2, zejtar 21, bujq 25, kafexhinjë 9, mjek (farmacist) 1, nëpunës 1, rentier 5, liferant 3 dhe të tjerë 19.²⁹

Prokuroria Publike e Serbisë me 3 mars u kishte dërguar të gjitha Prokurorive Publike të Qarqeve që edhe një herë të shqyrtojnë gabimet dhe plotësimet me rastin e përcaktimit të komisioneve dhe vlerësimet të tyre, ngase sipas kësaj prokurorie ka shumë ankesa që duhet të shqyrtohen.³⁰ Kërkohet që të dërgohen të gjitha shënimet për përfituesit e luftës të shënuara në formular të veçantë.³¹

Menjëherë pas lufte ishin formuar edhe komisionet për përcaktimin e “kriminelëve të luftës” dhe ndihmësve të tij. Sipas të dhënave arkivore të cilat i zotërojmë, me vendimin e Gjyqit të Rrethit në Istog (Burim) ishte konfiskuar pasuria e “armiqve të popullit” në vlerën: tokë pune 105 hektar, pyje 777 hektar, 5 shtëpi, ndërtesa me material të fortë- një stallë, një mulli me dy gurë, tre hambar drithi dhe 4 kosa për misër, 10 lopë, 6 viça, 2 palë kije, 3 buaj, 1 kalë, 27 dele, dhe 10 dhi. Sipas këtij raporti pranë Gjyqit të Rrethit në Istog ka edhe shumë lëndë që duhet shqyrtuar për konfiskim të pasurisë. Këto vendime i referohen datës 10.7. 1946.³² Konfiskime të tilla kishte pasur edhe në vitin 1945, por nuk kishin qenë të mjaftueshme për pushtetin prandaj ato kishin vazhduar edhe vitet në vijim e sidomos kështu ishte vepruar ndaj të gjithë atyre që kishin kundërshtuar sistemin komunist.

Në Biltenin nr.9 të dt. 26.2. deri 4.3.1950 të Prokurorisë Publike të Kosovës jepen edhe këto të dhëna: Në shkurt të vitit 1950 janë konfiskua 97,45% të drithërave dhe prej tyre në sektorin privat 97,7% dhe në sektorin shoqëror 106,6% . Po ashtu janë konfiskua 116% e kafshëve të trasha dhe 36% e kafshëve të imëta, fasule 85,6% , kashtë 66%, sanë 81,8% dhe yndyrë 63,6%. Në Biltenin nr.27 të datës 2-8 korik jepen të dhëna të shumëta kundër atyre që kanë kundërshtua konfiskimin e

29 Po aty.

30 *AK. Fondi. Prokuroria Publike-Prizren* Odeljenje AG-GR, 1945/46 K-2

31 *AK. Prokuroria Publike Prizren* Odeljenje AG.GR. 1945/46 K-2

32 *Ak Fondi, Lista e konfiskimit , proces verbale dhe shkresat e ndryshme te gjitha komunave, K-1, Dok. Pokretna i nepokretna imovina koja je od Sreskog Narodnog Suda u Istoku konfiskovana resenjima i odluke po drugi put donete od suda za konfiskaciju -imovine narodnih neprijatelja.*

pasurisë , sidomos të lashtave dhe kafshve shtëpiake që kanë varëfrua familjet shqiptare.

Ankesa të tilla kishte veçmas për Rrethin e Sharit, Rrethin e Moravës së Epërme (Gjilanit), Rrethin e Pejës, të Kamenicës etj.³³

Konfiskimi i pasurisë në Gjakovë

Masa të tilla u zbatuan edhe në komuna tjera .Ushtria Naciona-
lçlirimtare më të hyrë ne Gjakovë filloi plaçkitjen e familjeve në zë si
dhe të atyre që kishin kundërshtuar mbetjen e Kosovës nën Serbi.

Janë të neveritshme numërimi i gjësendeve të plaçkitura nga
UNÇ -e “ armiqve të popullit” dhe “përfituesve të luftës” siç i quanin
ata, si : qilim, dollap, krevat, karige, jorgan, perde, pasqyrë, biçikletë,
filxhanë kafeje, radio, pjatë, gota për raki, tepsi, tavolinë e gjësende
tjera amëvisnie.³⁴ Është me interes të cekët se gjësendet e cekura të
plaçkitura nga Ushtria NÇ pjesa më të madhe iu ishte ndarë OZN-
së Alo Abdiquit dhe Vuçko Radenoviqit. Për ti bërë pjesë të këtij ak-
sioni gjësende të imta kuzhine iu ndan edhe shqiptarëve pjesëtar dhe
përkrahës të Luftës antifashiste.³⁵ Kjo ishte bërë me qëllim maskimi
veprimi i UNÇ –së.

Edhe në Gjakovë format e varëfrimit të shqiptarëve ishin të
shumta e të llojshme. Gjjobat ndaj shqiptarëve për pasurin e patundëshme
të tyre, plaçkitjet dhe marrja me dhunë e “tepricës” ishte zhargon i për-
ditëshmerisë së veprimeve komuniste.

Në Prokurorinë Publike të Gjakovës kishin arrit 339 ankesa për
padrejtësit e bëra ndaj shqiptarëve dhe vetëm 78 ishin shqyrtuar kurse
261 ishin refuzuar.³⁶

“ Përfituesit e luftës” sipas komisionit për krime lufte në Gjakovë

Edhe për shtresën e pasur të Gjakovës ishin përpiluar lista me
emra të shqiptarëve që pushteti i konsideronte si “përfitues lufte”.

33 A.K. Fondi .Prokurori Publike Prishtinë-“Bilteni nr.9 dhe nr. 27, dt. 2-8 korik
1950.

34 Po aty , Lista e konfiskimit të pasurisë për Gjakovë e dt. 29. 07. 1946.

35 Po aty.

36 A.K. Fondi. Prokuroria Publike ,K-3 ,viti 1950.

Në listën e përfituesve të luftës, figurojnë 40 veta :

1.SHERAFEDIN BUNJAKU nga Gjakova, me profesion rrobaqepës, më 6.V. 1941 pasuria e tij ishte vlerësua 145,000 din ndërsa me 9.V.1945 është konstatuar se fitimi i luftës i ka sjellë pasuri në shumën prej 345.000 din.

2.VËLLEZËRIT RIZVANOLLI, auto-transport (autobus), sipas dokumentit që posedojmë më 6.V.1941, pasuria e tyre vlerësohej në 565.000 din. E njëjta shifër paraqitet edhe në vitin 1945 , ndërsa është konstatuar se ka përfitime lufte në vlerë prej 2.500.300. din.

3.VËLLEZËRIT DUSHI, me profesion tregtar, në vitin 1941 pasuria e tyre është vlerësuar 262.000 din., në vitin 1945 kjo shumë ngritët 322,000 din. ndërsa sipas organeve verifikuese pasuria e vëllezërve Dushi pas lufte arrin shifrën prej 1.340.000 din.

4.ISA ,vëllezërit, Braushi tregtar, shuma e pasurisë sipas këtij dokumenti në vitin 1941 ishte 110.000. Gjatë vitit 1945 ishte 125.000 din. ndërsa komisioni vlerësues i ngritur në vitin 1945 kishte konstatuar se pasuria e tyre si "përfitues lufte" ishte 248.700 din.

5.VËLLEZËRIT SPAHIJA, shpeditër, sipas dokumentit që posedojmë në vitin 1941 pasuria e tyre arrinte shumën prej 150.000 din. Pas lufte përkatësisht në vitin 1945 ishte vlerësuar në 194.346,87 din. ndërsa përfitimi gjatë lufte ishte vlerësuar 82.640.

6.FETË VULA, tregtar i vogël, në vitin 1941 pasuria e tij ishte vlerësuar 195.000 din. Ky vlerësim kishte qenë edhe në vitin 1945. Për ta renditur në listën e përfituesve të luftës pasuria e tij vlerësohej 247.288. din.

7.MON GREZDA, tregtar, në vitin 1941 pasuria e tij ishte vlerësuar 436.000 din., ndërsa në vitin 1945 ishte ngritur ne 710.000 din. me përfitim lufte prej 356.200 din.

8.HAMFI GJOCI, tregtar, në vitin 1941 pasuria e tij ishte vlerësuar 189.000. Në vitin 1945 ishte ngritur në 366.500 din., ndërsa komisioni vlerësues kishte konstatuar se përfitimi gjatë lufte kishte arrit shumën prej 378.300 din.

9.ABDYL ZHURI, tregtar nga Gjakova, në vitin 1941 pasuria e tij kapte shumën prej 475.000 din., ndërsa në vitin 1945 arrinte 266.000 din. Pas lufte komisioni vlerësues e kishte dënuar si përfitues lufte me vlerësimin se kishte fituar 750.000 din.

10. MUHARREM KURHASANI, monopol-mall dhe tregti, nga Tropoja. Në vitin 1941 pasuria e tij ishte vlerësuar me shumë prej 240.000. Në vitin 1945 kishte arrit në 303.000 din. I vlerësuar pas lufte si përfitues me shumë prej 750.000 din.

11. RIZA E GJELADIN KOMONI tregtarë. Në vitin 1941 sipas dokumentit që posedojmë vlera e përgjithshme e pasurisë së tij vlerësohej të këtë qenë 114.000 din. Në vitin 1945 ishte ngritur në 119.000 din., ndërsa si përfitues lufte ishte vlerësuar me shumë prej 1.300.000 din.

12. DIN LAMA, tregtar, nga Gjakova. Pasuria e tij në vitin 1941 ishte vlerësuar 156.000 din. Në vitin 1945 kishte arrit në 284.5000 din., ndërsa komisioni vlerësues e kishte rradhitur në përfitues lufte me shumë prej 468.000.

13. RAMADAN LLESHI, tregtar, nga Gjakova. Në vitin 1941 pasuria e tij ishte vlerësuar 100.000 din. Në vitin 1945 kjo pasuri ishte vlerësuar 121.000 din., ndërsa përfitimi i luftës sipas komisionit vlerësues ishte 300.000 din.

14. HASAN MULLA SHABANI, tregtar, nga Gjakova. Pasuria e tij në vitin 1941 ishte vlerësuar 108.000 din., ndërsa në vitin 1945 kishte ngritur në 128.000 din. Komisioni vlerësues i pasurisë e kishte rradhitur në listën e përfituesve të luftës me shumë prej 2.070.000 din.

15. VEHBI JUSUF MEÇA, tregtar, nga Gjakova. Në vitin 1941 pasuria e tij ishte vlerësuar 90.000 din. Pas lufte, përkatësisht në vitin 1945 ishte ngritur në 115.000 din., ndërsa komisioni kishte vlerësuar se profitet e luftës i kishte të larta me shumë prej 1.500.000 din.

16. ABDURAHIM NAGAVCI, tregtar, nga Gjakova. Pasuria e tij në vitin 1941 ishte vlerësuar në 65.000 din., pas lufte përkatësisht në vitin 1945 ishte ngritur në 89.000 din. Komisioni vlerësues e rradhit në përfitues lufte me shumë prej 500.000 din.

17. ILIAZ POLLOSHKA, tregtar, nga Gjakova. Në vitin 1951 pasuria e tij vlerësohej 135.000 din. Në vitin 1945 ishte zbritur në 110.000 din., ndërsa përfitimi i luftës vlerësohej 393.875 din.

18. HALIL PRUTHI, tregtar, nga Gjakova. Në vitin 1941 pasuria e tij ishte vlerësuar 34.5000 din., ndërsa më 9.V.1945 ishte ngritur në 92.000 din. Komisioni vlerësues e kishte rradhitur në përfitues lufte me shifrën prej 37.290.

19.RASIM RIZVANOLLI, tregtar, nga Gjakova. Në vitin 1941 pasuria e tij ishte vlerësuar 370.000 din. Pas luftime, përkatësisht në vitin 1945 ishte ngritur në 403.000 din. Profitet e luftës komisioni i kishte vlerësuar me shumën 500.000 din.

20.RAMADAN SAHATQIA, tregtar, nga Gjakova. Vlera e pasurisë së tij në vitin 1941 vlerësohej 148.000 din., ndërsa më 9.5.1945 ngritej në 151.000 din. Pas luftime ishte vlerësuar si përfitues i luftime me shumën prej 192.5000 din.

21.EJUP SARAÇI, saraç, nga Gjakova. Në vitin 1941 pasuria e tij ishte vlerësuar 18.000 din., ndërsa në vitin 1945 kishte zbritur në 9.000 din. Komisioni vlerësues nuk e dimë se në çfarë mbështetje e kishte vlerësuar si përfitues i luftime me shumën prej 364.000 din

22.LYTFI SPAHIJA, tregtar, nga Gjakova. Në vitin 1941 vlera e përgjithshme e pasurisë ishte 1.285.000 din. Pas luftime përkatësisht në vitin 1945 ishte zbritur në 848.146 din., ndërsa komisioni kishte caktuar shumën e profitit të luftës prej 1.000.000 din.

23.RAGIP TAFARSHIKU, tregtar, nga Gjakova. Në vitin 1941 pasuria e tij kishte kap shumën prej 156.5000 din. Në vitin 1945 kjo pasuri ishte vlerësuar 181.500 din. Komisioni kishte vlerësuar se përfitimet e luftës kishin arritur shumën prej 1.500.000 din.

24.DRAGO TRISHIQ, farmacist, nga Gjakova. Në vitin 1941 vlera e përgjithshme e pasurisë ishte vlerësuar 643.898 din. Në vitin 1945 i ishte zbritur në 48.556 din., ndërsa ishte vlerësuar si përfitues i luftime me shumën prej 1.300.000 din.

25.MUHEDIN HAXHI NIXHA, tregtar, nga Gjakova. Në vitin 1941 pasuria e tij ishte vlerësuar 94.000. Edhe në vitin 1945 kishte mbetur po e njëjta vlerë, ndërsa komisioni vlerësues për pasurim gjatë luftime e kishte ngritur shumën në 322.000 din.

26.FETË CANHASI, bukëpjekës, nga Gjakova. Në vitin 1941 pasuria e tij ishte vlerësuar 148.000 din., në vitin 1945 ishte ngritur në 150.000 din., ndërsa komisioni verifikues pasurimin gjatë luftime e kishte vlerësuar 250.000 din.

27.SHAQIR CANA, kasap, nga Gjakova. Pasuria e tij në vitin 1941 ishte vlerësuar 377.000 din., ndërsa në vitin 1945 kishte zbritur 247.000 din. Komisioni vlerësues kishte caktuar shumën e përfitimit gjatë luftime në 1.000.000 din.

28.RAGIP SHLLAKU, metalpunues. Në vitin 1941 pasuria e tij vlerësohej 135.000 din., pas luftime, në vitin 1945, ishte ngritur në 155.000 din., ndërsa ishte vlerësuar se përfitimi i luftës kapte shumë prej 400.000 din.

29.SADIK IRZNIQI, tregtar, nga Gjakova. Në vitin 1941 pasuria e tij vlerësohej 67.000 din. Pas luftime përkatsisht në vitin 1945 ishte 52.000 din., ndërsa komisioni vlerësuar për përcaktimin e pasurisë fitimin gjatë luftime kishte vlerësuar 276.000 din.

30.TAHIR NAGAFCI, tregtar, nga Gjakova. Në dokumentin që posedojmë mungojnë të dhënat për vlerën e pasurisë së tij para dhe gjatë LDB-e por figuron shifra se përfitimi i luftes ishte 1.840.000 din.

31.AQIF MULLA ADEMI, rrobaqepës, nga Gjakova. Në vitin 1941 pasuria e tij vlerësohej 128.000 din. po e njëjta mbetet edhe në vitin 1945. Si përfitues luftime vlerësohet me shumë prej 390.000 din.

32.ISMAIL DOBRUNA, tregtar, nga Gjakova, në vitin 1941 prona e tij ishte vlerësuar 480.000 din. Pas luftime kjo shifër dukshëm ishte zbritur 247.000 din., ndërsa ishte vlerësuar me shumë të lartë si përfitues luftime 464.588.

33.ISMAIL RIZVANILLI, tregtar, nga Gjakova. Pasuria e tij në vitin 1941 ishte 2.000.000 din. Në vitin 1945 ishte zbritur në 1.500.000 din., ndërsa ishte vlerësuar se gjatë luftime kishte fituar 2.680.000 din.

34.QAZIM GOJANI, tregtar, nga Gjakova. Për të nuk ka shifra që do ta provonin pasurinë e tij para dhe pas luftime, mirëpo profiti i luftës vlerësohej 520.000 din.

35.ISMET STAVILECI, tregtar, nga Gjakova. Në vitin 1941 vlera e pasurisë së tij ishte 135.000 din. Në vitin 1945 ishte ngritur në 156.000 din. Komisioni kishte vlerësuar se gjatë luftime kishte përfituar 334.000 din.

36. IBRAHIM KOMONI, tregtar, nga Gjakova. Në vitin 1941 pasuria e tij vlerësohej 116.000 din. Në vitin 1945 kishte mbet shifra e njëjtë, ndërsa ishte vlerësuar si përfitues luftime me shumë prej 345.000 din.

37.SALI GOJANI, hekurishtar, nga Gjakova. Nuk ka të dhëna për pasurinë e tij para dhe pas luftime, mirëpo vlerësohej si përfitues luftime me shumë prej 3.250.000 din.

38.QAZIM GAXHA, tregtar, nga Gjakova. Para luftime pasuria e tij vlerësohej 300.000 din., gjatë luftime mungojnë të dhënat, pas luftime ishte vlerësua se gjatë luftime përfitime kishte pasur 1.950.000 din.

39.KOSTA STEFIQ, tregtar, nga Gjakova. Në vitin 1941 pasuria e tij vlerësohej 571.000 din. Pas luftime përkatësisht në vitin 1945 kishte zbritur në 274.000 din., ndërsa si përfitues luftime ishte caktuar shuma 428.000 din.

40.LUKA JOVANOVIQ, profesioni i palexueshëm, nga Gjakova. Në vitin 1941 pasuria e tij ishte vlerësuar 230.000 din. Në vitin 1945 ajo ishte 221.100 din., ndërsa profiti i luftës ishte vlerësuar 168.000 din.

Nga këto të dhëna konstatojmë se në shumë raste gjambat e "përfituesve të luftës" sipas komisionit vlerësues, ishin shumë më të mëdha se vlera e pasurisë gjatë dhe pas luftime. Kjo bëhej me qëllim të konfiskimit sa më të madh të pasurisë së shqiptarëve për nevojat e shtetit dhe strukturave të tij që padyshim çonte në varëfrimin e shqiptarëve .

Nga raportet e shumta të kësaj natyre hasim në ankesa të shumta të qytetarëve për parregullësi në grabitjen e paligjshme të pasurisë së tyre. Në vitin 1950 në Prokurorin Publike të Kosovës kishin arritur 339 ankesa që fshatarët e Rrethit të Gjakovës kishin bërë kundër vendimeve jo të drejta ndaj tyre për marrjen e tepricës.

Nga ky numër ishin shqyrtuar 78 ndërsa 261 ishin refuzuar. Vetëm nga Skivjani kishte 147 ankesa.³⁷ Siç po shihet nga këto të dhëna, shteti për ta mbushur arkën e vet kishte dënuar shqiptar me shuma marramendëse që nuk i mbulonin mundësitë e pagesës, duke e zhveshur shqiptarët deri në palcë. Pushteti i kohës dhe strukturat e tij, nuk kishin konsideratë as ndaj atyre që bijtë e tyre ishin filijuar në luftë kundër okupatorit e as ata që okupatori i kishte plaçkitur e grabitur gjatë luftime. Pas këtyre masave familjet shqiptare dukshëm u varfëruan dhe nën trusnin edhe të pushtetit shumica prej tyre në valën e shpërnguljeve të mëdha shqiptare të viteve 1945-1966 u detyruan të lëshonin Kosovën.

Thenë shkurt periudha e viteve 1945-1966 për shqiptarët e Kosovës në shumë drejtime paraqet njëren prej sfidave më të mëdha të mbijetesës politike, ekonomike, kulturore dhe jetësore.

37 AK. Fondi Prokuroria Publike, K- 3, viti 1950.

Prof. Dr. Sulltane KOJQINI-UKAJ

SUMMARY

YUGOSLAV AUTHORITIES VIOLENCE AGAINST ALBANIANS IN PEJA REGION AFTER WWII

Serbian drive for genocide employed abundant forms of discrimination against Albanians during and after WWII. During fascist occupation Serbian circles compiled programs for extermination of Albanians as Stevan Molevic's, Vasa Çubrilovic's and many others. In this spirit, on January 1945 OZN office for Kosova had ordered massive persecution of influential Albanians.

This order was followed in region of Peja, also. Between November 1944 and December 1945 were executed without trial 3600 men from town of Peja. Murders, imprisonments, forced mobilization of Albanians by Yugoslav Army, confiscation of wealth from poor population were some of the forms of violence that were carried out against Albanians in first years after the War. In few words, period 1945 – 1966 in many ways represents one of major challenges to political, economical, cultural and physical survival of Albanians in Kosova.